



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 79, Datë 23.03.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË  
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 12 dhe neneve 46 dhe 56, të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 53, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 38/3 prot., datë 18.03.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shtyrjen e afatit të vendimarrjes për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Pas kërkesave të përsëritura të aplikuesit për zgjatjen e afatit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim, ERE me vendimet nr. 43, datë 06.03.2020, nr. 119, datë 17.07.2020 dhe së fundmi, me vendimin nr. 179, datë 04.11.2020, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.03.2021.
- Ndërkohë përpara përfundimit të afatit të sipërcituar, shoqëria “Albgaz” sh.a., ka paraqitur shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454 prot., datë 18.03.2021, duke kërkuar sërish shtyrjen e këtij afati procedural deri në datën 20.09.2021, për shkak se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë Covid-19, dhe si e tillë shoqëria Albgaz sh.a., nuk disponon ende të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE.
- Kërkesa e “ALBGAZ” sh.a., rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative i cili përcakton se:

*3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.09.2021.
2. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 10.09.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**